



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Edmond Rrushi, Alban Zeneli, Ylli Shehu, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Elena Xhina dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj dhe Anduel Xhindi.

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako – Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile.

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Albana Agastra (Qehajaj) - Këshilltare për Mediet në Ministrinë e Mbrojtjes

Artan Shiqerukaj - Drejtor i Drejtorisë Juridike, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve
në Ministrinë e Mbrojtjes

Agim Muslia - Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë dhe IT-së në Ministrinë e Mbrojtjes.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për mbrojtjen civile”. Për faktin se ky është një projektligj i ri, i cili shfuqizon ligjin aktual “Për emergjencat civile”, besoj se do të na duhet një kohë e gjatë jo vetëm ditën e sotme, por edhe ditën e nesërme për t’i përmbyllur diskutimet në lidhje me këtë projektligj.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes, zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zotin Haki Çako, drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe përfaqësues të tjerë.

Relator i Komisionit të Sigurisë Kombëtare për këtë projektligj është zoti Sadi Vorpsi.

Për kolegët dhe për mediet dua të theksoj se sjellja e këtij projektligji është një hap i rëndësishëm, sepse, më në fund, pas 18 vjetësh që vepron ligji “Për emergjencat civile”, ne kemi mundësi të sjellim një projekt të ri, i cili priret që të rregullojë, të planifikojë dhe të përballojë më mirë emergjencat civile. Besoj se *begraundi* i fatkeqësive të ndryshme natyrore ose jonatyrore, që kanë ndodhur gjatë këtij harku kohor relativisht të gjatë, na kanë ndihmuar që të reflektojmë zgjidhjet e duhura në këtë projekt.

Sidoqoftë, për të mësuar më shumë rreth këtij projekti dhe për të parë se cilat do të jenë strukturat e reja institucionale që do të përballojnë këto fatkeqësi në rang qendror apo vendor, si dhe për të kuptuar se cili do të jetë angazhimi i njësive të pushtetit lokal në përballimin e fatkeqësive të ndryshme, të cilat dëmtojnë jetën e njerëzve, pronën, trashëgiminë e të tjera, do t’i jap fjalën zotit Petro Koçi për të prezantuar projektligjin. Më pas fjala do të jetë për relatorin, zotin Vorpsi.

Fjala është për ju, zoti Koçi.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Së pari, dua t'ju kërkoj falje që ministrja nuk mundi të vinte, sepse duke qenë se ky është komision përgjegjës ajo duhej të vinte vetë për relatuar projektligjin.

Së dyti, më lejoni t'ju prezantoj projektligjin nga pikëpamja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e vetë qeverisë.

Projektligji që po diskutojmë sot shënon një moment shumë të rëndësishëm jo vetëm për punën e Ministrisë së Mbrojtjes, por edhe për punën e këtij komisioni. Ky projektligj reformon një sektor shumë të rëndësishëm, sepse ka të bëjë me garantimin e sigurisë së qytetarëve shqiptarë. Nuk ka asnjë dyshim që projektligji “Për mbrojtjen civile” shënon fillimin e një transformimi të madh në qasjen e shtetit shqiptar ndaj çështjeve të emergjencave dhe të mbrojtjes civile në tërësi. Siç e dini ka kaluar rreth një vit e gjysmë që kur përgjegjësia për emergjencat civile bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile kanë kaluar te Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 12.01.2018 dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 47, datë 09.03.2018. Ishte një përgjegjësi e madhe, por që, në fakt, reflekton filozofinë e re që udhëheq sot veprimtarinë e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila fokusohet në një përkufizim shumë më të gjerë të sigurisë sesa thjesht tek aktivitetet luftarake apo te mbrojtja e territorit, duke mbuluar një gamë shumë më të larmishme kërcënimesh që i kanosen sigurisë së qytetarëve. Ndihehi mirë që gjatë kësaj periudhe kemi ditur të përballojmë më së miri këtë përgjegjësi të re, por sfidat nuk kanë munguar. Kështu, u përballuan dhe u menaxhuan me sukses përmbytjet në Jug të vendit në vitin 2018; përmbytjen në qarkun e Shkodrës në mars të vitit 2018; zjarret gjatë vitit 2018, por edhe gjatë muajve të parë të këtij viti; tërmetet në Dibër dhe Lezhë në muajin gusht të vitit 2018 apo edhe ai i këtij viti në Korçë. Përtej këtyre situatave emergjente kemi realizuar edhe disa projekte të rëndësishme parandaluese, ku do të veçoja forcimin e argjinaturës në lumin Vjosë, bërë kjo në bashkëpunim me Bashkinë e Fierit, duke siguruar komunitetin atje nga rreziku i përmbytjeve të vazhdueshme.

Sot që flasim janë 400 milionë lekë, pra rreth 4 milionë dollarë, të akorduara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për emergjencat civile, me qëllim realizimin e disa projekteve të përgatitura nga Ministria e Bujqësisë për ndërtim argjinaturash dhe rehabilitim të shtretërve të disa lumenjve, duke siguruar kështu komunitetet e këtyre zonave, kryesisht përgjatë Shkumbinit dhe Vjosës, por edhe përgjatë disa përrenjve problematikë si ai i Pllanës apo ai i Troshanit, nga rreziku i përmbytjeve.

Në këtë pikë dua të theksoj fort diçka që kemi pasur rastin ta diskutojmë edhe më parë, me të paktën disa prej jush. Këtë opinion dua ta ndaj me kolegët, të cilët i ka lidhur puna me emergjencat. Nëse këto situata janë përballuar me sukses kjo i detyrohet në radhë të parë profesionalizmit, shpirtit të sakrificës dhe përkushtimit të burrave, djemve dhe vajzave që janë angazhuar në përballimin e tyre. E them këtë, sepse situatat në fjalë ishin të vështira jo thjesht për shkak të furisë së natyrës, por edhe për shkak të problemeve të mëdha strukturore, ligjore, dhe organizative që kemi hasur në punën tonë. Kjo eksperiencë na bindi dhe na motivoi edhe më shumë për reformimin e këtij sektori. Ajo çfarë ne konstatuam gjatë periudhës një vit e gjysmë të funksionimit të strukturës së emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes, ishte nevoja e ngutshme për kryerjen e një reforme të thellë ligjore, strukturore dhe organizative në këtë sektor, që duhej të fillonte me një ligj të ri për mbrojtjen civile, që do të zëvendësonte ligjin “Për emergjencat civile”, i cili daton nga viti 2001.

Më poshtë do të them disa nga risitë kryesore që sjell ky projektligj, por në hyrje dua të theksoj absolutisht se pjesa më e rëndësishme e këtij projektligji është se ai sjell një revolucion në qasjen tonë ndaj emergjencave, duke e zhvendosur fokusin nga reagimi te parandalimi dhe te zvogëlimi i riskut. E vërteta është se gjatë dekadave të fundit ka pasur një shpërfillje dhe një mungesë përgjegjësie të plotë ndaj parapërgatitjes apo zvogëlimit të riskut. Ndërkohë që lidhur me reagimin ka pasur herë pas here nisma pozitive, sidomos gjatë viteve të fundit, kur edhe falë mbështetjes së aleatëve tanë janë rritur kapacitetet reaguese, por nuk është bërë thuajse asgjë për të ndërtuar një mekanizëm të ri për përballimin e emergjencave, i cili ta vendoste theksin te zvogëlimi i risqeve.

Është e vështirë të shpjegosh këtë mungesë përgjegjshmërie, pasi koncepti i zvogëlimit të riskut shërben si boshti i organizimit të mbrojtjes civile në shumë vende të botës, sidomos në vendet aleate të NATO-s qysh në fillimin e viteve '90. Për më tepër, të gjithë specialistët në çdo raport ndërkombëtar kanë thënë se Shqipëria është një ndër 10 vendet e para në botë për sa i përket riskut të lartë ekonomik, ku 86% e territorit ku prodhohet 88,5% e PBB-së është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Në raportin e riskut botëror të vitit 2016, që duhet thënë se ishte një kampanë alarmi për të gjithë ne për sa i përket indeksit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, thuhet se Shqipëria renditet vendi më i rrezikuar në Europë dhe i 40 në botë. Sigurisht, këtyre kërcënimeve u duhen shtuar edhe ato që burojnë nga ndryshimet klimatike, pasojat e të cilave i hasim edhe ne. Mjafton të kujtojmë këtu se si kanë ndryshuar ekstremet e temperaturave me ngrica në periudhën

e dimrit dhe temperaturat ekstreme gjatë muajve të verës apo situatat e reshjeve dhe rreziqet e përmytjeve që sjellin ato. Ne nuk mund të mjaftohemi vetëm duke reaguar me emergjenca, sepse një qasje e tillë është thjeshtë e paqëndrueshme dhe e papërballueshme nga të gjitha pikëpamjet projektligji “Për mbrojtjen civile” sjell një ndryshim vërtet të rëndësishëm pikërisht në këtë drejtim. Ndaj, sot krahas fuqizimit të kapaciteteve reaguese fillon edhe puna për të zvogëluar risqet me të cilat përballlet vendi ynë dhe qytetarët. Kjo është një qasje identike me atë që zbatohet tashmë prej kohësh në mjekësi, ku çdo mjek mund t’ju thotë se parandalimi jo vetëm është më shumë efikas, por edhe me kosto më të ulët sesa reagimi ndaj sëmundjes dhe adresimi i pasojave të saj.

Po ashtu, ajo që vlen për t’u theksuar është fakti se duke miratuar këtë ligj, Shqipëria përmbush parametrat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për vitet 2015-2030, e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Ky ligj, më në fund, i hap rrugë anëtarësimit të Shqipërisë në mekanizmin e mbrojtjes civile europiane, që është një mekanizëm bashkëpunimi dhe koordinimi për të reaguar ndaj fatkeqësive në Europë dhe më gjerë. Është një fakt i papranueshëm që sot në të gjithë rajonin vetëm Shqipëria, Kosova dhe Bosnje-Hercegovina mbeten ende jashtë këtij mekanizmi si pasojë e neglizhencës për të reformuar këtë sektor gjatë dekadave të fundit.

Zbatimi i këtij ligji, ndërtimi i mekanizmit që ai parashikon kërkon shumë punë dhe shumë angazhim nga një sërë institucionesh. Po ashtu, kërkon edhe më shumë koordinim ndërinstitutional, më shumë kapacitete dhe më shumë fleksibilitet në adresimin e çështjeve për zvogëlimin e riskut dhe mbrojtjen civile, çka nuk mund të arrihet nëpërmjet strukturës aktuale. Prandaj, një nga risitë themelore që sjell projektligji, i cili, në fakt, është edhe nga rekomandimet kryesore të aleatëve, sidomos atyre amerikanë, të cilët dëshiroj t’i falënderoj për mbështetjen e tyre, është edhe transformimi i drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Kjo do të jetë një strukturë e përhershme ndërinstitutionale e nivelit të lartë me më shumë autoritet, me kapacitete shumë më të mëdha administrative, teknike dhe financiare krahasuar me ato aktuale që ka Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Kjo agjenci do të ketë përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera të krahasueshme edhe me strukturat homologe.

Po ashtu vlen për t’u theksuar se ky projektligj reflekton gjetjet dhe rekomandimet e disa raporteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, ku do të veçoja: raportin e Komandës Amerikane në Europë në korrik të vitit 2014; raportin e vlerësimit të ekipit të mbrojtjes civile të

BE-së të hartuar pas përmbytyjeve të vitit 2015; raportin e vlerësimi të nevojave pas fatkeqësisë, i bërë pas përmbytyjeve të shkurtit të vitit 2015, asistuar nga OKB-ja, Banka Botërore dhe BE-ja, si dhe raportet e progresit të viteve të fundit të Komisionit European për Shqipërinë.

Emëruesi i përbashkët i këtyre raporteve është nevoja për fokusimin te politikat e reduktimit të riskut dhe zhvendosjen e fokusit nga menaxhimi i fatkeqësive te menaxhimi i risqeve të tyre.

Eksperienca jonë në menaxhimin e emergjencave na ndërgjegjësoi edhe për një tjetër aspekt shumë të rëndësishëm, që lidhet me nevojën për një ndarje të qartë të përgjegjësisë të çdo aktori institucional, veçanërisht nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat deri më sot kanë neglizhuar në një masë të madhe respektimin e parimit të subsidiaritetit edhe pse ky parim është sanksionuar me ligj qysh në vitin 2015. Nisur nga këto dy rekomandime kryesore, do të veçoja disa risi të tjera të projektligjit, si më poshtë :

- përcakton Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë si dokumentin bazë strategjik të Republikës së Shqipërisë në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, çka është një mënyrë eksplicite e gjetjeve të përvitshme të Komisionit European, si dhe për vetë respektimin e objektivit 5 “Sendai” të OKB-së;

- vendos tavane të qarta për përqindjen e buxhetit për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive si dhe mbrojtjen civile nga 2 deri në 4% në ministrinë e linjës dhe 4% të buxhetit të bashkive;

- sanksionon detyrimin për hartimin e strategjisë së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në çdo njësi të qeverisjes vendore;

- sanksionon detyrimin për përgatitjen e dokumentit të vlerësimit të riskut dhe planeve të emergjencës civile në nivel qendror, të prefekturës dhe të bashkisë;

- ndan qartë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve në tërësi dhe detyrimet specifike, që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të parashikuara në përputhje me kuadrin “Sendai”;

- i kushton vëmendje të posaçme mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore;

- bën të detyrueshëm planin për emergjencat civile për institucionet dhe për subjektet private në shëndetësi, në arsim, në mirëqenie sociale, në kulturë, në mjedis dhe në turizëm, si dhe për subjektet që prodhojnë dhe magazinojnë materiale të rrezikshme, si: karburante dhe derivate të tyre, gazra energjetike, si dhe ato që kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme;

- përmban sanksione të qarta për të gjitha institucionet publike, subjektet private sikurse përcakton qartë edhe funksionimin e mekanizmit të inspektimit;

- rrit në mënyrë thelbësore rolin e prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

- mundëson krijimin e bazës së të dhënave për fatkeqësinë në tri nivele sikurse sanksionohet në detyrimin e vlerësimit të dëmeve të fatkeqësive nga ministritë dhe bashkitë;

- plotëson dhe përafron legjislacionin tonë me 4 direktivat e BE-së.

Në këtë pikëpamje kjo është një arritje, e cila vlen shumë për procesin e hapjes së negociatave me Bashkimin Europain.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Dua të theksoj se projekti në fjalë është shumë i rëndësishëm dhe për këtë arsye nuk do të ketë vetëm vëmendjen e komisionit tonë, si komision përgjegjës, por do të ketë edhe vëmendjen e disa komisioneve të tjera parlamentare.

Kështu, dita e nesërme do të na shërbejë për t’u siguruar për cilësinë e ligjit. Kuptohet që ligji ka synime të mira, sepse synon të zvogëlojë riskun nga fatkeqësitë, njëkohësisht edhe të modernizojë sistemin e mbrojtjes civile.

Për të kuptuar më mirë se cilat janë detyrimet e të gjithë aktorëve në rastet e fatkeqësive, unë do të doja t’ia kaloja fjalën relatorit dhe më pas kolegëve për të vijuar me pyetjet në parim për projektin.

Fjala për ju, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti zëvendësministër,

Për hir të së vërtetës, unë e dëgjova me vëmendje të gjithë parashtrimin tuaj. Në fakt, ky projektligj është i vonuar për shkak të legjislacionit aktual, por, pavarësisht kësaj është një hap shumë i rëndësishëm për planifikimin, për monitorimin dhe, në mënyrë të veçantë, për menaxhimin e emergjencave civile të riskut, duke filluar nga qendrat në nivel qarku dhe ato vendore.

Legjislacioni aktual në fuqi në fushën e emergjencave civile paraqet një sërë mangësish, të cilat ndikojnë në të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave civile.

Ligji aktual nr. 8756/2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, por nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi. Edhe përcaktimet e tij për institucionet dhe strukturat qendrore dhe ato vendore, sikurse strukturat operacionale, të cilat janë përbërëse të sistemit të mbrojtjes civile, janë evidentuar prej vitesh që janë sa të cekëta aq edhe të pamjaftueshme për kohën. Në këtë mënyrë, kjo bazë ligjore është krejtësisht e vjetruar dhe nuk pasqyron aspak politikat e pranuar ndërkombëtarisht të zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dhe as politika të tjera të lidhura ngushtësisht me to, siç janë: Axfenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030; Marrëveshja e Parisit për ndryshimin e klimës, si dhe Axfenda e Re Urbane. Gjithashtu, në stadin aktual nuk është bërë ende implementimi në të gjithë vendin i numrit të thirrjeve pa pagesë 112, si numri i vetëm europian i thirrjeve emergjente.

Ndërhyrja është e nevojshme, me qëllim integrimin e prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, duke vlerësuar riskun nga fatkeqësitë, si dhe plane të emergjencave civile në nivelin qendror, qarku dhe vendor, si dhe masa të tjera. Me rëndësi të veçantë janë disa direktiva dhe vendime të BE-së në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, të cilat kanë nevojë për përafrim.

Objektivat dhe efektet që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj nisme janë si më poshtë:

- të zvogëlohet risku nga fatkeqësitë nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik të riskut dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjithë subjekteve të këtij ligji, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij;

- të forcohet sistemi i mbrojtjes civile nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

- të forcohen kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe të përgjegjësive të të gjithë aktorëve të këtij sistemi në nivel qendror, qarku dhe vendor;

- të përmirësohet edukimi për mbrojtjen civile në shkolla nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar;

- të parashikohen rregulla më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstytucional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe procedurave përkatëse;

- të rritet roli ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh, më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE-së, NATO-s, OKB-së, OSBE-së e të tjerë.

Projektligji do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri jo vetëm për menaxhimin e fatkeqësive, por edhe për vendosjen e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse në përputhje me terminologjinë europiane dhe botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, do të mundësojë arritjen e objektivave ligjore, si dhe do të kontribuojë në integrimin e Shqipërisë në BE.

Për ta mbyllur, dua të citoj edhe një nga risitë e këtij projektligji. Natyrisht dua të përmend se planifikimi i njësive të vetëqeverisjes vendore kap tavanit prej 4% të të gjitha fondeve të kushtëzuara, natyrisht edhe planifikimi në rang ministrie do të jetë nga 2 deri në 4%. Nga eksperiencia ime mendoj se kjo është një risi. Duke iu rikthyer edhe retrospektivës, ndoshta është një nga nevojat më të mëdha që ka sot vendi. Unë do t'ju kujtoj vetëm një fakt, që sot në qarkun e Tiranës, duke e lidhur me këtë 4%-in, janë përgjithësisht 78 ujëmbledhës, ndërkohë që me reformën e re administrativo-territoriale të vitit 2015 të gjithë këta ujëmbledhës iu kaluan njësive vendore, ndërkohë që fondi i parashikuar për bashkitë në këta vjet ka qenë pothuajse zero. Më duhet të citoj se kemi të bëjmë me një minë me sahat, ku mbi 95% të këtyre ujëmbledhësve nuk u punojnë shkarkuesit katastrofik. Mendojeni vetë se çfarë mund të ndodhë nesër. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me shërbimin e zjarrfikësve, që, përsëri me reformën administrativo-territoriale, u kanë kaluar njësive të qeverisjes vendore dhe ku nuk është investuar pothuajse fare. Ndoshta është investuar vetëm në disa bashki, ndërkohë që shërbimi zjarrfikës në rastet e emergjencave civile është ai që përballlet më shumë me terrenin dhe me situatën e emergjencës. Pra, investimi për sa u përket të gjithë këtyre trupave ka qenë zero nga njësitë e qeverisjes vendore. Natyrisht, tani fondi prej 4% është një risi për t'i përdorur këto si fonde të kushtëzuara nga qeveria, gjithmonë për pjesën e parandalimit, që ne e kemi cituar edhe në ligj.

Ftoj kolegët deputetë që ta miratojmë në tërësi këtë projektligj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi, që e vutë theksin në gjëra konkrete!

Në fakt, unë besoj se ne kemi nevojë të ndajmë me publikun disa gjëra konkrete që i sjell ky projekt. Ndaj jo vetëm numri unik 112 për emergjencat civile, që është një numër europian, por, mbi të gjitha, le ta vendosim theksin te detyrimet që do të kenë autoritetet lokale dhe ato qendrore për të ndarë buxhet nga buxhetet që u akordohen çdo vit vetëm për përballimin e emergjencave civile. Këtë gjë e kemi diskutuar më shumë se një herë në Komisionin e Sigurisë dhe besoj se drejt saj duhet të shkojmë detyrimisht. Pra, së pari bashkitë duhet të ndajnë një fond për përballimin e çdo emergjence civile në territorin e tyre dhe më vjen mirë që keni parashikuar që 4% të buxhetit të bashkive të shkojnë për këtë pjesë, sikundër edhe për institucionet qendrore të të gjitha ministrive, të cilat për shkak të profilit të tyre të punës angazhohen në përballimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore ose jo. Po kështu edhe ato duhet të ecin në të njëjtën linjë, duke përcaktuar deri në 8% pjesën e buxhetit të tyre për përballimin e emergjencave civile. Gjithsesi, për këto tema natyrisht lindin pyetje dhe diskutime. Kështu që unë nuk do të humbas më shumë kohë, por do t'ua kaloj fjalën kolegëve për pyetje.

Po, zoti Maliqi.

Lefter Maliqi - Faleminderit, zonja kryetare!

Për të ftuarit kam disa pyetje informuese, të cilat mund t'i duhen publikut, por edhe komisionit.

Së pari, kemi disa ndryshime të emergjencave civile në mbrojtjen civile. Unë doja të dija se cilat janë këto ndryshime për sa i përket strukturës organike për dijeni, si dhe kompetencat e drejtorit të mbrojtjes civile në krahasim me emergjencën civile, që do të thotë emërimi, varësia dhe të gjitha me radhë nëse ka ndonjë ndryshim apo jo? A ka ndonjë ndryshim në shtabet e mbrojtjes civile në qendër në krahasim me shtabet e emergjencave civilen në bazë qarku apo prefekturë? A ka ndonjë shtim në organikë apo në mjete për posedimin e tyre e të tjera me radhë?

Këtu u fol për 4% të buxhetit të pushtetit lokal që duhet t'u kalojë si fond emergjencave civile. Këtu dëgjova se Drejtoria e Mbrojtjes Civile do të merret me rregullimin e argjinaturave, ndaj a nuk do të ishte më mirë që në pushtetin lokal këto fonde t'i kishte vetë pushteti lokal? Kjo për arsye se ata e dinë më shumë se ku i dhemb, pasi e njohin më mirë territorin sesa mbrojtja civile në qendër.

Ka më shumë se një muaj që banorët e fshatrave të Korçës pësuan disa herë dëme materiale, pësuan shembjet e shtëpive nga tërmetet, dhe iu premtua për rindërtimin e shtëpive. Kjo është pjesa

më emergjente civile, por Drejtoria e Emergjencave Civile ende nuk është marrë me rindërtimin e shtëpive të tyre. Kjo gjë duhet të bëhet nga prefektura apo nga bashkia, pra nga pushteti lokal? A ka ndonjë afat për rindërtimin e shtëpive të tyre?

Pyetja tjetër është thjesht për dijeni dhe informim. Meqenëse ne jemi pjesë e Aleancës së Atlantikut të Veriut të NATO-s, por edhe po të mos ishim pjesë ka raste që NATO ndërhyt ushtarakisht jo vetëm për vendosjen e paqes, por edhe në rastet e fatkeqësive natyrore. Në cilat raste ndërhyt NATO-ja dhe kur kërkohet ndihma e dhënë? Në disa raste ne kemi pasur ndihma nga vendet fqinje, por unë dua të di se në cilat raste të fatkeqësive të mëdha kërkohet ndihmë nga NATO-ja?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Maliqi!

Kush do ta marrë fjalën prej jush?

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Maliqi për pyetjet!

Ligji nuk përcakton strukturën e ardhshme të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por, sigurisht, rrit më tej përgjegjësitë që ka kjo agjenci në raport me Drejtorinë aktuale të Emergjencave Civile. Më pas do të jetë vendimi i Këshillit të Ministrave që do të përcaktojë organikën, drejtuesin dhe kompetencat në përgjithësi. Ne duhet të kuptojmë se ky ligj i jep një qasje tjetër trajtimit të fatkeqësive, pra nga trajtimi reagues, që ne kemi sot pasi ndodh fatkeqësia, në një qasje tjetër ku do të përfshihen: identifikimi, monitorimi, vlerësimi dhe parandalimi i risqeve që sjellin fatkeqësitë. Pra, do të jetë një qasje më gjithëpërfshirëse krahasuar me qasjen që ka qenë deri tani. Duhet thënë se është jashtë standardeve jo vetëm me kuadrin “Sendai”, jo vetëm me mekanizmin europian të mbrojtjes civile, por edhe me vetë kapacitetet që ka Shqipëria për t’u përballur me këtë sfidë, siç është zvogëlimi i risqeve.

Për sa i përket pushtetit vendor është thënë se 4% e fondeve të kushtëzuara do t’i dedikohen mbrojtjes civile. Kjo do të thotë se do të jetë vetë pushteti vendor që do të vendosë se cilat do të jenë projektet parandaluese ndaj risqeve dhe ndaj fatkeqësive. Pra, ky fond nuk do të jetë thjesht reagues ndaj emergjencave, por, kryesisht, do të jetë për masa parandaluese. Unë do të sugjeroja projekte, të cilat mund të jenë për përdorim të dyfishtë. Pra, mund të jenë projekte që do të shërbejnë për mbrojtjen civile, por ndërkohë mund të shërbejnë edhe për programet e pushtetit vendor. Në këtë pikëpamje këtë fond nuk duhet ta zotërojë Ministria e Mbrojtjes. Kështu, edhe pse

ne sot jemi të angazhuar për të rregulluar argjinaturën e lumit Vjosë në Fier, këtë detyrim është duke e kryer Bashkia e Fierit. Atje janë vetëm mjetet e Forcave të Armatosura dhe personeli që shërben për ta realizuar atë projekt, por gjithmonë me mbështetjen financiare të pushtetit vendor, duke ofruar karburantin përkatës.

Për sa i përket çështjes së rindërtimit të banesave të dëmtuara apo të shkatërruara plotësisht në Korçë, mund të them se ne jemi në vijim të procesit. Besoj se këto ditë do të ketë edhe lajme për publikun për fillimin e procesit të rindërtimit të shtëpive. Ky është një angazhim, të cilin e ka ndërmarrë qeveria dhe besoj se në vjeshtë ky projekt do të jetë realizuar 100%.

Për sa i përket angazhimit të NATO-s, kuptohet që NATO-ja nuk mund të angazhohet për emergjencë apo situata të emergjencave lokale. Ne urojmë që këto lloj fatkeqësish të mos ndodhin kurrë jo vetëm te ne, por në asnjë vend të NATO-s. NATO-ja vepron vetëm në rastet e emergjencave kombëtare dhe për këto raste patjetër që NATO-ja ka mekanizmat e saj të solidaritetit, ka strukturat dhe kapacitetet e nevojshme, për të angazhuar drejtpërdrejt emergjencat kombëtare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zoti Murrizi, fjala është për ju.

Myslym Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë, në fakt, doja të informohesha. Ju thatë se me ngritjen e këtij institucioni të ri doni të fuqizoni më shumë ligjin aktual, i cili ekziston që nga viti 2001. Çfarë patët parasysh kur vendosët t’i ndryshonit emrin, pra nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave në Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile? Pra, çfarë fuqie potenciale në njerëz dhe në buxhet të shtetit do të marrë ky lloj ndryshimi sipas këtij ligji? Çfarë ndikimi do të ketë ndryshimi i emrit nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave në Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile?

Së dyti, ju thatë se thelbi kryesor i të gjithë ligjit është parandalimi. Në fakt, ndoshta nuk e kam kuptuar mirë, por, përderisa kjo agjenci apo kjo drejtori do të merret me fatkeqësitë natyrore, unë nuk e di si mund të parandalohen ato. A do të dalim ne mbi Zotin apo ku di unë se çfarë mund të bëjmë? Unë nuk e di nëse kjo Agjenci ka ndonjë mekanizëm që mund të parandalojë, për shembull, tërmetin, sepse ju thatë se thelbi i këtij ligji është parandalimi? Mua këto më duken si sofizma apo demagogji të shokut Enver, që i jepte urdhër Zotit dhe fatkeqësitë nuk ndodhnin më. A pyet i madhi Zot se çfarë do të bësh ti me ligj?! Pra, unë vura re se i gjithë qëllimi juaj për këtë

ligj është të parandaloni fatkeqësitë. Jo më larg se para 2 ditësh 400 milionë banorë të Amerikës, që është një super shtet, mbetën pa drita 16 orë dhe atje u përmytën 2 apo 3 shtete. Pse? Sepse Zoti e kishte në dorë vetë dhe nuk pyeti Trampin, por as ai nuk është se i dha leje Zotit që të bënte përmytje, por e pati vetë në dorë.

Zoti Çako, sa është numri i punonjësve që ka sot kjo drejtori, e cila nesër do të quhet agjenci? A do të plotësohet ajo me kuadër ligjor apo me udhëzime përkatëse për të bërë njëfarë ndarjeje? Çfarë risie do të sjellë ligji i ri? A do të ketë shtim në organikë, në logjistikë, në mjete dhe në infrastrukturë, çka do të jenë drejtpërdrejt në varësinë tuaj si drejtor i kësaj drejtorie që jeni sot, por besoj se do të vazhdoni të jeni edhe më pas? Pra, çfarë risie do të sjell ky ligj?

Zoti Koçi tha se po ndërtohet argjinatura në lumin Vjosë. Unë, personalisht, bashkë me zotin Subashi, si deputet i qarkut, i kemi parë përmytjet që kanë ndodhur në Fier dhe atje ishin Forcat e Armatosura. A janë Forcat e Armatosura në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile apo janë në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes? Pra, unë dua të di, në pozitën që ju jeni aktualisht, çfarë keni në dorë të urdhëroni? A keni ju kompetenca apo nuk keni fare, se në dijeninë time më duket sikur nuk keni asnjë kompetencë? Pra, ju keni vetëm disa fadroma, që vijnë nëse do apo jo ministria. Pra, çfarë fuqizohet me këtë ligj?

Së fundi, nuk e di nëse këtu ka ndonjë përfaqësues, që merret me anën financiare, sepse ju nuk jeni të detyruar të përgjigjeni dhe ndoshta nuk keni as kompetentë për ta bërë këtë gjë. Besoj se ky ligj do të kalojë ditën e enjte dhe i duhen edhe 15 ditë për të hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndaj i bie që të hyjë në fuqi nga fillimi i gushtit. A do të ketë ndonjë ndryshim në ligjin e ri këta 4 muaj? A keni parashikuar ndonjë gjë nga buxheti i shtetit për ta bërë këtë agjenci më eficiente në funksion të ligjit të ri?

Unë do të doja një përgjigje nga zoti Koçi ose nga zoti Çako. A mos ka ardhur koha që ju të bëheni iniciuesit për ndryshimin e ligjit të siguracioneve? Fenomeni që vëmë re shpesh janë përmytjet, sepse shembjet e shtëpive nga tërmetet kanë qenë të pakta. Pra, fatkeqësitë më të shpeshta kanë qenë përmytjet masive të banesave, por edhe të prodhimeve bujqësore, ku janë përmytur me mijëra hektarë tokë. Ne sot në Shqipëri nuk kemi asnjë kompani sigurimesh, të cilat marrin përsipër të sigurojnë qoftë të mbjellat e fermerëve, por, mesa di unë, as banesat në rastet e fatkeqësive natyrore. A mos duhet që këto kompani sigurimesh të detyrohen me ligj (sepse ato vjelin jo pak të ardhura nga qytetarët), që t'u përgjigjen qytetarëve, të cilët kanë mundësi të sigurojnë banesën edhe pse jetojnë dhe punojnë jashtë vendit? Pra, këta njerëz mund të gjejnë

mundësinë, që ashtu siç mund të jenë të siguruara ndërtesat shtetërore, të sigurojnë banesën e tyre me përqindje dhe këto kompani sigurimesh të mund t'i dëshmshpërblejnë për dëmet që mund të kenë pësuar në bazë të siguracioneve që këta njerëz kanë bërë. Mbase kjo gjë do të lehtësonte në njëfarë mënyre edhe vetë emergjencën civile. Pra, a mund të merret një nismë e tillë nga ju për të bërë një ligj, i cili do t'i detyrojë këto kompani sigurimesh, sepse që të gjitha private, të pranojnë edhe siguracione për bujqit, por edhe për banesat për ata që kanë të ardhura?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Murrizi!

Në fakt, ligji është bërë duke shfrytëzuar eksperiencën sllovene, të Kosovës, njëkohësisht kanë dhënë ekspertizën e tyre edhe përfaqësuesit e Departamentit të Mbrojtjes Civile të Italisë.

Ndërkohë, përveç zotit Çako, këtu është edhe zoti Maksimiljan Dhima, drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, i cili ka përvojë më të gjatë se të tjerët për sa u përket emergjencave civile.

Zoti Dhima ka qenë pjesë e takimit kur ne kemi folur për emergjencat civile. Kështu që besoj se pyetjeve tuaja mund t'u përgjigjet secili prej të pranishmëve. Kam përshtypjen se ju pyetjet i kishit për zotin Çako, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Petro Koçi – Po, mund t'i kombinojmë përgjigjet.

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi!

Më pas mund ta plotësoni vetë njëri-tjetrin për përgjigjet.

Petro Koçi – Së pari, projektligji zvogëlon konceptin e qasjes ndaj fatkeqësive të riskut. Pra, në qoftë se ligji aktual ka qasjen reaguese postfatkeqsisë, me projektligjin e ri ka një qasje tjetër që lidhet me identifikimin, vlerësimin, monitorimin, pse jo edhe me parandalimin e risqeve nga fatkeqësitë. Thelbi nuk është thjesht parandalimi, sepse unë jam dakord me shprehjen “varet nga përmasa e fatkeqësisë”, sepse ka fatkeqësi natyre, të cilat janë të përmasave të mëdha që nuk i parandalon dot as Amerika. Gjithsesi, duke parë traditën e ngjarjeve të fatkeqësive të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, ne mund të marrim masa parandaluese, ashtu siç po bëjmë sot me argjinaturën e lumit Vjosë. Kjo do të thotë se organet e qeverisjes vendore kanë mundësi që me projekte të veçanta të ndërhyjnë për të marrë masa parandaluese sipas terrenit, sipas historisë së fatkeqësive, përmbajtjeve, terrenit të gjeografisë apo hartës lumore e të tjerë apo historisë së rreshjeve në territorin e çdo njësie vendore. Pra, nuk është thjesht parandalimi, sepse është e

pamundur të parandalosh, por fokusi i ligjit është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë. Prandaj, kjo ka një qasje tjetër, e cila është më gjithëpërfshirëse, më ndërinstytucionale. Pra, në qoftë deri dje emergjenca civile e kishte më të thjeshtë kur ishte në varësinë e Ministrisë së Brendshme dhe i duhej të reagoje pasi ndodhte fatkeqësia. Nga viti 2017 ne filluam të mendonim për ta trajtuar ndryshe këtë qasje, sidomos për shkak të prezencës së ekspertëve italianë të Departamentit të Mbrojtjes Civile Italiane, të cilët erdhën në Shqipëri në fundit e viti 2017, nëse ju kujtohet, kur ndodhën përmbytjet në Jug dhe në Veri të vendit. Pas këtyre ngjarjeve ka filluar hartimi i këtij projektligji, duke u mbështetur te modeli slloven për arsye të ngjashmërisë së vendit, përmasave të shtetit e të tjerë. Pra, në qendër është modeli slloven, por na kanë vlejtur shumë edhe leksionet dhe modeli i ekspertizës që vjen nga Departamenti i Mbrojtjes Civile Italiane.

Për pyetjet e tjera do të përgjigjet zoti Çako.

Ermonela Felaj – Po, zoti Çako!

Haki Çako - Përshëndetje të gjithëve!

Përshëndetje, zonja kryetare!

Në mënyrë të veçantë ju falënderoj për vlerësimin që i dhatë këtij projektligji, pasi, në gjykimin tim, konsiderohet së paku si një nga projektligjet më të rëndësishme. Ndaj, është marrë në konsideratë që të quhet si një reformë tërësore në aspektin e mbrojtjes civile, pasi ligji i vitit 2001 nuk merrte në konsideratë shumë gjëra, të cilat i përmendi edhe zoti Vorpsi.

Lidhur me pyetjen që zoti Murrizi me të drejtë e bëri, dua të sqaroj se çfarë do të thotë reduktim i riskut në raport me menaxhimin. Ky është një fokus, i cili është vënë në qendër të vëmendjes sot nga të gjitha institucionet, por edhe nga të gjitha vendet e tjera të botës.

Kuadri “Sendai” është një dokument i OKB-së i miratuar në vitin 2015 me një afat 2015-2030. Më saktë është një rregullore ku specifikohen të gjitha masat dhe përgjegjësitë që duhet të marrin të gjitha institucionet në kuadër të parandalimit ose të profilaksisë. Pra, në qoftë se përpara se të ndodhë një fatkeqësi natyrore (logjikisht kur ka përmasa të jashtëzakonshme, efekti human është i pallogaritshëm në raport me çfarë sjell ajo), janë një sërë fenomenesh, të cilat kushtëzohen nga iniciativa apo nga kontributet dhe nga investimet që ne bëjmë paraprakisht. Nga analiza që i ka bërë OKB-ja thuajse shumicës së fenomeneve dhe ngjarjeve, nëse investohet 1 dollar para se të ndodhë fenomeni, atëherë kursehen 7 dollarë nëse do të duhet të investosh në momentin kur ndodh fatkeqësia, për menaxhimin e fenomenit. Sigurisht kjo lidhet edhe me një sërë masash që i dedikohen pikërisht iniciativave dhe dorës shkatërruese të njeriut që, në fund të fundit, faktori

natyrë jep efektet e saj nëse ne nuk jemi të kujdesshëm me natyrën apo edhe me procese të caktuara, të cilat e parandalojnë këtë fatkeqësi. Përtej kësaj, pothuajse në të gjitha forumet ndërkombëtare, sidomos mekanizmi i mbrojtjes civile në Europë është i fokusuar veçanërisht në një investim shumë herë më të madh, që nuk ka të bëjë vetëm me aspektin financiar më shumë se sa me investimin, me reduktimin e riskut, me angazhimin human të njerëzve, si dhe me angazhimin e të gjitha strukturave, duke përmendur si një nga çelësat e këtij ligji çështjen e vullnetarizmit. Kjo do të thotë se njerëzit duhet të ndryshojnë jo vetëm qasjen, por edhe konceptin lidhur me angazhimin në çështjen e menaxhimit të mbrojtjes civile, në mënyrë të veçantë për fatkeqësitë natyrore, por edhe për fatkeqësi të ndryshme, siç mund të jenë: fatkeqësitë teknologjike, apo dhe fatkeqësi të tjera, si rezultat i veprimeve njerëzore, që marrin përmasa të jashtëzakonshme.

Në këtë kuadër ligji në tërësi konsiderohet një risi, sepse merr në konsideratë dhe specifikon jo vetëm terminologjinë në përputhje të plotë me 4 direktivat kryesore të BE-së dhe me 2 vendimet e Këshillit të Ministrave të Bashkimit European, ku ne duhet të përqasemi, por edhe institucionet do të duhet të bëhen shumë herë më kohësi. Sikurse pushteti lokal apo bashkitë, por edhe të gjitha njësitë e pushtetit vendor, është mirë që atë buxhet që kanë planifikuar ta investojnë hap pas hapi, me qëllim që në momentin kur të ndodhin fatkeqësitë të jenë më të përgatitur, duke i paraprirë situatës.

Dua të sqaroj diçka lidhur me çështjen e strukturës. Ligji përcakton parimet bazë, përcakton ndryshimin dhe transformimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, e cila aktualisht, për hir të së vërtetës, është një strukturë shumë e reduktuar, që nuk ka pasur vëmendjen e duhur që prej vitit 2001 kur është bërë ligji. Shpeshherë në perceptimin e qytetarëve kjo strukturë është konsideruar si gjigante, por *de facto* është një strukturë shumë e vogël. Ndaj, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ashtu si edhe ligji, i është referuar strukturave homologe. Kryesisht, ne kemi qenë në konsulencë të plotë dhe nën përkujdesjen e Departamentit të Mbrojtjes Civile italiane, pavarësisht se ka përmasa dhe ka të tjera nivele dhe struktura. Nga ky departament ne kemi marrë ekspertizën më të mirë, ashtu sikurse kemi marrë edhe ekspertizën sllovene, kroate, austriake, por edhe të vendeve të tjera të rajonit, pasi një nga parimet bazë, por edhe orientimi kryesor i ligjit është bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërajonal, pasi fenomenet natyrore dhe fatkeqësitë nuk janë lokale në tërësi, por janë fenomene që marrin përmasa më të mëdha dhe duhet të ketë një bashkërendim. Pra, nëse ndodh një tërmet, ai nuk është se i ndan kufijtë, ashtu si edhe fatkeqësitë e tjera që ndodhin nuk kanë të bëjnë me gjuhën apo gjeografinë. Kështu që Agjencia

Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të jetë një strukturë, të paktën e parashikuar edhe në bazë të ligjit, shumë herë më e madhe nga ajo strukturë që është sot.

Objektivi dhe prioriteti kryesor është zbatimi ndërinstitucional i politikave të qeverisë shqiptare lidhur me reduktimin e riskut dhe me mbrojtjen civile. Brenda saj do të ketë ekspertë, inxhinierë, por edhe gjithçka që është e domosdoshme për të koordinuar punën.

Dua të sqaroj edhe një moment tjetër. Brenda ligjit është përcaktuar qartë se cilat do të jenë strukturat operacionale, që do të vijnë përpos zbatimit të detyrave që ka Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Të gjitha strukturat e tjera, duke filluar nga Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, emergjencat shëndetësore, mbrojtja nga zjarri, pavarësisht se në çfarë institucioneesh janë të instaluar ato janë struktura operacionale, të cilat në momentin e ndodhjes së një fatkeqësie ose të një situatë emergjente do të vihen në dispozicion dhe do të angazhohen për menaxhimin e këtyre situatave.

Në lidhje me buxhetin, sigurisht që ligji ka përcaktuar qartë nevojën, por edhe përcaktimin e një buxheti që do të korrespondojë me organizmin, funksionimin dhe strukturën e Agjencisë së Mbrojtjes Civile, por edhe me përcaktimin dhe detajimin e nevojave të tjera. Pra, buxheti normalisht duhet të fillojë që nga janari i vitit 2020 i planifikuar, pasi duhet të parashikohet nga PBA-ja, që është një domosdoshmëri. E vlerësoj shumë dhe e konsideroj shumë të rëndësishëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, janë një sërë aktesh që do të pasojnë pas miratimit të ligjit, janë vendimet e Këshillit të Ministrave, duke filluar që nga organizimi, struktura, funksionimi, buxheti e të tjera.

E vlerësoj shumë çështjen e konceptit të siguracionit, e cila, për hir të së vërtetës, është një çështje që lidhet më shumë me edukatën qytetare në tërësi, sesa me detyrimin ligjor, sipas mendimit tim. Dua të theksoj se lidhet shumë edhe me informalitetin ekonomik, që ekziston realisht në Shqipëri. Shumë familje, shumë fermerë, shumë struktura e konsiderojnë të dhimbshëm investimin në momentin e sigurimit pranë këtyre kompanive, por një biznes i siguruar, qoftë ai industrial apo bujqësor e të tjerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ka të bëjë me ligjin për siguracionet dhe është një iniciativë tjetër që sigurisht duhet të merret.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në fushën e përgjegjësisë së këtij ligji nuk mund të ketë detyrime në lidhje me siguracionet, pasi ka një ligj tjetër, i cili do të duhet të kompensojë dhe të ndihmojë këtë ligj në implementimin e tij për çështjen e siguracioneve.

Gjithsesi, ju falënderoj dhe jam dakord se ka shumë gjëra që duhet të sqarohen, por me kalimin e kohës do t'u vijmë në ndihmë të gjithë qytetarëve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Çako!

Fjalën e ka zonja Dhima

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët janë prezent këtu për të prezantuar projektligjin “Për mbrojtjen civile”!

Më vjen mirë që sot po diskutojmë një projektligj shumë të rëndësishëm, i cili ka në qëllimin e tij zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, garantimin e mbrojtjes së jetës së njerëzve, të pronës dhe të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore, njëkohësisht, edhe të mjedisit. Ky ligj përcakton qartë të gjitha përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi.

Unë kam tri pyetje. Së pari, në projektligj në kompetencat e prefektit të qarkut, ju përcaktoni se prefekti ka kompetencë të kthejë buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore në qoftë se nuk kanë parashikuar 4% të buxhetit të kushtëzuar. Çfarë ideje keni ju kur thoni “buxhet i kushtëzuar”? A mos ndoshta buxheti duhet të jetë i pakushtëzuar?

Së dyti, në projektligj janë përcaktuar edhe afatet konkrete të institucionit të prefektit, të këshillit bashkiak dhe të bashkisë. Unë mendoj se këto afate janë shumë të gjata, që normalisht duhet të rishikohen si afate ligjore. Pra, afati 3-vjeçar për nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtij projektligji më duket shumë i gjatë.

Së treti, zoti Çako, ju thatë se e keni parashikuar buxhetin në PBA ose jeni duke e diskutuar, sepse faktikisht tani është periudha që të gjitha ministrinë janë duke përgatitur buxhete afatmesme. Pyetja ime është: a keni ju vlerësim të situatës aktuale të gjendjes së lumenjve në të gjithë territorin e vendit dhe të urave, të cilat janë ndërtuar mbi këta lumenj?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhima!

(Diskutime pa mikrofon)

Vetëm një nga ju mund të largohet, ndaj çmoheni vetë se kush do të jetë!

Haki Çako – A mund t’i përgjigjem zonjës Antoneta?

Ermonela Felaj – Po.

Haki Çako – Atëherë, lidhur me detyrimin e prefektit për të kushtëzuar buxhetin e bashkive, mund të them se ky është një mekanizëm, i cili mundëson kontrollin dhe vendosjen e dyshemesë për çështjen e buxhetimit nga bashkia. Ai e kushtëzon vetëm një herë dhe më pas kuptohet që nuk është absolute. Ajo çfarë e bën të detyrueshëm këtë gjë është se duhet të diskutohet fillimisht çështja e buxhetit të financuar nga qeveria.

Afatet ligjore janë parashikuar në bazën e strategjive, ku është marrë në konsideratë koha e nevojshme dhe e domosdoshme për të miratuar strategjinë kombëtare të mbrojtjes civile, përpos strategjisë rajonale dhe planeve konkrete vendore.

Lidhur me vlerësimin për çështjen e gjendjes së lumenjve, të rezervuarëve dhe të të gjitha urave dhe situatës në përgjithësi, mund të them se institucionet përgjegjëse në fushën e përgjegjësisë, të cilët duhet të merren me menaxhimin e tyre, kanë bërë edhe studimet, edhe analizat konkrete, sikurse është Ministria e Bujqërisë, Ministria e Infrastrukturës si dhe të gjitha ministritë e tjera. Ne administrojmë dhe marrim në analizë situatat e fenomeneve dhe të fatkeqësive të ndodhura. Gjithsesi, jemi në bashkëpunim dhe në një ndërveprim institucional, ndaj është marrë në konsideratë që ky institucion të jetë si koordinatori ndërinstitutional.

Ermonela Felaj – Kam përshtypjen se zonja Dhima nuk e mori përgjigjen e pyetjes së saj, kështu që do të bëjë edhe një ndërhyrje tjetër.

Antoneta Dhima – Pyetja ime e parë ishte në lidhje me grantin e kushtëzuar. Çfarë mendoni ju ose çfarë keni përfshirë te ky 4%-shi?

Ermonela Felaj – Po, zoti Shehu.

Ismail Shehu - E nderuar kryetare!

Të nderuar anëtarë,

Fond i kushtëzuar është ajo pjesë e buxhetit që marrin bashkitë nga të cilat do të mbahet 4%-shi. Pra, në qoftë se buxheti i bashkisë, sipas ligjit të qeverisjes vendore, i ka të përcaktuara të ardhurat që do të krijohen nga taksat, tatimet dhe fondet që kalojnë nga njësia qendrore, këto të dyja do të ndahen: “të kushtëzuara” dhe “të pakushtëzuara”. 4%-shi do të mbahet te fondet e kushtëzuara që do të transferohen nga njësia qendrore në buxhetin e bashkisë. Pra, 4%-shi do të dalë nga këto fonde, në mënyrë që ne të mos futemi në tagrin dhe në kompetencat e bashkisë për ta rregulluar buxhetin, por do ta gjykojnë vetë këshillat bashkiake. Pra, prefekti i qarkut në këtë

pikë do të ketë kompetencë të ndërhyjë dhe ta kthejë vetëm një herë, siç e njeh ligji, vetëm në rast se nga këto fonde të kushtëzuara, bashkia përkatëse nuk ka mbajtur detyrimin minimal prej 4% për çështjen e emergjencave civile. Pra, në qoftë se ky buxhet, që në thelb është një akt normativ, nuk e parashikon këtë përqindje të detyrueshme minimale buxhetore, atëherë prefekti brenda tagrit të tij e kthen mbrapsht këtë buxhet, ashtu siç ia njeh ligji.

Lidhur me pyetjen...

Ermonela Felaj – Më falni!

Ju do t'ia jepni si zë më vete këtë nga buxheti qendror apo do të cenohet buxheti i bashkive? Me këtë ky buxhet do të cenohet, sepse i kushtëzuar është nominal.

Ismail Shehu – Buxheti i bashkisë për pjesën që e vjelë vetë, pra nga taksat, nga tarifat e të tjerë nuk do të preket absolutisht, por pjesa e kushtëzuar, që do të marrë nga qeveria do të shkojë e kushtëzuar për emergjencat civile. Pra, në qoftë se unë të jap 10 lekë të kushtëzuara, 4 lekë do të jenë për emergjencat civile, ndërsa pjesa që bashkitë i vjelin vetë nuk preket, sepse nuk ta lejon ligji ta prekësh pjesën tjetër.

Antoneta Dhima – Edhe një herë: granti i kushtëzuar i jepet pushtetit vendor nga pushteti qendror dhe quhet “i kushtëzuar”. Ti nuk mund të ndërhysh këtu, sepse është për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, për arsimin parauniversitar, është i specifikuar për pyjet dhe kullotat, është i specifikuar për kanalet kulluese dhe vaditëse e të tjerë.

Granti i pakushtëzuar është kompetencë e pushtetit vendor që ta ndajë si të dojë, ndaj unë po të pyes: a është i kushtëzuar apo i pakushtëzuar? Te pjesa e pakushtëzuar është pushteti vendor që do të vendosë për pagat, për sigurimet, për shpenzimet operative, për investimet, por edhe për emergjencat civile. Pra, unë mendoj se ai që duhet të korrigjohet është granti i pakushtëzuar, jo ai i kushtëzuar, sepse te granti i kushtëzuar nuk ka të drejtë të ndërhyjë pushteti vendor, pasi është me destinacion për t'u përdorur për shkollat, për kopshtet, për kanalet ujitëse dhe kulluese, kështu që nuk mund të ndërhyjë pushteti vendor. Te granti i pakushtëzuar mund të ndërhyjë, sepse granti i pakushtëzuar është totali i grantit që i jep qeveria pushtetit vendor dhe pushteti vendor nëpërmjet këshillit bashkiak ka të drejtë ta përdorë ku të dojë. Unë mendoj se ky 4%-shi duhet të jetë te granti i pakushtëzuar dhe jo tek ai i kushtëzuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A mund ta sqarojmë edhe një herë këtë pikë. Në fakt, kam përshtypjen se nuk është sqarim prej juristi, sepse duhet t'i bashkojmë të gjitha kontributet bashkë, edhe të

ekonomistëve. Këtu ka një nonsens, sepse në qoftë se është i kushtëzuar, domethënë që nuk e ndërron dot destinimin, atëherë pse duhet ndërhyrja e prefektit, se çfarë do të kthejë ai pastaj? Bashkitë nuk duhet ta bëjnë këtë gjë, nuk mund ta ndërrojnë fondin. Pra, brenda vetë parashikimit duket se ka një nonsens. Megjithatë, mund të na e sqaroni përsëri.

Petro Koçi – Po e sqaroj edhe njëherë: ky është fond i kushtëzuar, domethënë e kushtëzon buxhetin e bashkisë që të përdoret 4% për çështje të mbrojtjes civile.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj - Atëherë, i bie që ju e kushtëzoni që në fillim, sepse ti i kërkon çdo bashkie një fond 2% deri në 4% për mbrojtjen civile.

Petro Koçi – Është 4% e lart.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Prandaj, nuk po e kuptojmë këtë pjesë. Atëherë, në qoftë se këtë fond e përcakton vetë qeveria dhe më pas ua kalon bashkive, atëherë bashkitë nuk kanë se çfarë të përcaktojnë.

Petro Koçi – Projektin konkret e përcaktojnë vetë bashkitë, por do të jetë i dedikuar për mbrojtjen civile.

(Diskutime pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Një sqarim të hollësishëm. Pushteti qendror në miratimin e buxhetit, sepse komisioni ynë është pjesë e miratimit të buxhetit, akordon një grant të pakushtëzuar dhe një të kushtëzuar. Në qoftë se qeveria këtë pjesë të kompetencave ia ka kaluar pushtetit vendor, ku përfshihen edhe emergjencat civile, duke akorduar 5 lekë të kushtëzuar për emergjencat, atëherë prefekti kontrollon nëse ky 5 lekësh është përfshirë në buxhet dhe kështu jemi dakord, por këtu nuk thuhet kështu, ndaj mendoj se duhet riparë formulimi. Pra, në qoftë se bashkia përveç kompetencave të zjarrfikësve, përveç kompetencave të arsimit parauniversitar të pyjeve dhe kullotave, të kanaleve kulluese dhe vaditëse do të marrë në kompetencë edhe emergjencat civile, atëherë ne kemi të drejtë që nëpërmjet institucionit të prefektit të kontrollojmë këtë fond, i cili u është deleguar 61 bashkive me destinacion të kushtëzuar për emergjencat civile dhe këtu jemi dakord.

Ermonela Felaj – Nëse do ta lexoni fjalinë me vëmendje nuk është tamam ashtu, kështu që kur të vijmë te diskutimi nen për nen, atë fjali ne do ta korrigjojmë që të dalë qartësisht që kushtëzimin e vendos shteti, e vendos Këshilli i Ministrave, e vendos parlamenti në momentein që

miraton buxhetin. Detyrimi i bashkive është që atë fond ta përkthejë për mbrojtjen civile dhe detyrimi më tej i prefektit është të kujdeset që e gjitha kjo të ndodhë.

Petro Koçi – Edhe në Ministrinë e Financave kjo ka qenë një nga çështjet më të debatuar, ndaj ne kemi arritur në këtë zgjidhje.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Në rregull, të mos hyjmë te fondet!

Fjala është për zotin Zeneli.

Alban Zeneli - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Unë kam vetëm një pyetje për zotërinjtë e ftuar. Normalisht ky ligj është absolutisht shumë më i rëndësishëm se të gjitha projektligjet që kanë kaluar në komisionin tonë. Qasjen e këtij ligji, siç ka ardhur këtu, për uljen e riskut apo parandalimin e fatkeqësive e shikoj shumë të rëndësishëm, por dua një përgjigje nga ju: kjo qasje apo ky parandalim, siç shpreheni ju në këtë projektligj, është vetëm për fatkeqësitë natyrore apo edhe për rastet e tjera, sidomos kur fatkeqësitë vijnë nga dora e njeriut apo nga institucionet shtetërore? Nëse këto raste vijnë nga dora e njeriut apo nga institucionet shtetërore, a ka penalitete?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Ligji sjell risi edhe në fushën e sanksionimeve që fillojnë nga shtetasit e thjeshtë, nga subjektet private deri tek institucionet shtetërore, të cilat nuk respektojnë rregullat apo nuk marrin masa që lidhen me zvogëlimin e riskut. Pra, në vetvete kjo është një reformë nga reagimi ndaj emergjencave në një qasje tjetër, që është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për të gjitha llojet e fatkeqësive, të cilat i përmendi pak më parë edhe zoti Çako, përfshirë edhe aksidentet industriale, teknologjike apo ato që shkakton dora e njeriut, duke përfshirë zjarret e të tjerë, sepse, në fund të fundit, të gjitha quhen fatkeqësi.

Ermonela Felaj – Po, zoti Çako.

Haki Çako - Në lidhje me këtë mund të them se ligji ka parashikuar edhe inspektimin, ashtu sikurse ka parashikuar edhe dhënien e vërtetimit të riskut për çdo iniciativë apo për çdo

veprimtari tjetër. Në këtë kuadër janë detajuar dhe janë specifikuar edhe pasojat, që vijnë si rezultat i iniciativave të njerëzve.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çako!

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do t'i tërheq pyetjet për faktin se duke pasur në krahë zotin Vorpsi, si një ekspert shumë i mirë, i cili ka përvojë si prefekt, i mora disa përgjigje për të cilat unë dyshoja.

Në fakt, nuk më vjen mirë që ne po zgjatemi shumë në diskutime, pasi shikoj edhe mediet që nuk po paraqesin shumë interes, ndoshta kanë interes për komisionet e tjera. Dua të them vetëm diçka për drejtorin e emergjencave. Në fakt, aty ku gjërat i marrin në dorë ushtarakët, ndodhin gjëra të mira. Ky është fakt që me kalimin e këtij sektori pranë Ministrisë së Mbrojtjes u bë e mundur që të ndërmerret një hap i tillë edhe për ndryshimin e ligjit. Nuk dua të futem se nga cili dikaster vini zoti Çako, por po flas për seriozitetin e dikasterit ku ju ndodheni tani.

Zoti Murrizi me të drejtë shprehu se ne, si qeveri, nuk përgatisim sinoptikanë, të cilët duhet të parashikojnë se si do të jetë moti, por nuk bëjmë as atë çka thoshte Berisha, që në Shkodër ndodhin fatkeqësi të tilla një herë në 100 vjet. Kështu që me bërjen e këtij ligji, ne u japim zgjidhje shumë problemeve, të cilat vendi ynë ka hasur dhe vazhdon t'i vuajë edhe sot, qoftë nga zjarret, qoftë nga përmytjet, qoftë nga fatkeqësi të tjera natyrore. Kështu ne, si komision përgjegjës, kemi shansin të jemi pjesëmarrës për këtë ndryshim, i cili, për mendimin tim, është një ndryshim historik, sepse ky ligj do të përmbushë të gjitha nevojat dhe do të ulë në maksimum shkallën e riskut.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia, për diskutimin!

Fjala për ju zoti Harusha dhe më pas për zonjën Gjebrea.

Luan Harusha - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Unë jam deputete në qarkun e Shkodrës, ku fatkeqësitë natyrore ndodhin vit pas viti. A ka ndonjë strategji për këto fatkeqësi natyrore, sepse çdo vit në pika të caktuara aty ndodhin fatkeqësi? Mund të ketë shpenzime shumë të mëdha, por për mendimin tim janë shpenzime të kota.

Lumi Kir në qytetin e Shkodrës ka 30 vjet që nuk është pastruar asnjëherë. Si të gjithë lumenjtë e tjerë edhe ky lum mban mbetjet e të gjithë qytetit, ndaj Shkodra rrezikohet gjithmonë nga përmbytjet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Harusha!

Po, zoti Koçi

Petro Koçi – Atëherë, deri në shtator do të përcaktojmë një hartë të rreziqeve, ku do të përfshihet edhe çështja e lumenjve, që ngriti zoti Murrizi. Pra, do të përcaktohet qartë harta e rreziqeve që vijnë nga gjeografia, nga rrjedhjet lumore, nga reshjet e të tjerë. Gjithashtu, do të përcaktohet edhe një mënyrë reagimi, ku duhet bashkëpunuar në të gjitha nivelet e institucionit që nga ato vendore deri tek ato qendrore.

Për sa i përket Shkodrës, nuk është se kam ndonjë informacion konkret, por besoj se diçka nuk ka funksionuar në marrëdhëniet e qeverisë me Bashkinë e Shkodrës për projekte, të cilat kishin shërbim apo përdorim të dyfishtë, që lidheshin edhe me situatat e emergjencave. Nëpërmjet këtij ligji, siç e thamë, ndryshon edhe qasja. Pra, bashkitë do të jenë të detyruara, edhe në politikën e ndërtimeve urbane, që të reagojnë në përputhje me hartën e risqeve, me historinë e risqeve dhe të fatkeqësive në zona përkatëse. Kështu që, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të mbikëqyrë tërësinë e projekteve, që lidhen me qarqet apo edhe me bashkitë nga këndi i zvogëlimit të riskut dhe besoj se në çdo rast do të ndërhyjë në favor të zvogëlimit të riskut. Edhe nëse këto projekte i ka Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit apo bashkia, do të jetë pikërisht kjo agjenci, e cila do të luajë rolin e gardianit, që do të vështrojë nëse këto projekte e përmbushin kriterin e zvogëlimit të riskut apo jo. Në të kundërt pastaj do të reagojë në një nivel më të lartë për të ndaluar zbatimin e ndonjë projekti, i cili mund të pretendohet si një projekt zhvillimi, por që në të vërtetë sjell risk.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Zoti Koçi, po për Bashkinë e Shkodrës, e cila ka 30 vjet që drejtohet nga e djathta, ku nuk ka asnjë projekt nga qeveria, nuk mund të bëjmë asgjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ajo bashki drejtohet nga e djathta prej 30 vjetësh, por tani nuk bën projekte dhe nuk bashkëpunon me qeverinë e majtë. Çfarë zgjidhje do t'i japim kësaj bashkie?

Ermonela Felaj – Ligji është bërë për të gjitha bashkitë pa dallim ngjyre.

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Kjo është një çështje me natyrë të mirëfilltë politike, që, fatkeqësisht, haset shpesh. Një nga fatkeqësitë njerëzore në Republikën e Shqipërisë është mungesa e koordinimit kur ngjyrat politike vendore ndryshojnë nga ato qendrore. Kështu, shpesh nuk viktimizohet politika, por komuniteti dhe projektet e zhvillimit apo projektet që zvogëlojnë risqet. Natyrisht, me kalimin e viteve besoj se kultura jonë politike do të ndryshojë në favor të mirëkuptimit. Besoj se edhe ngjarjet e fundit politike, siç e tha edhe zoti Murrizi, ajo falja e pushtetit vendor, do të bëjë të vetën pozitivisht këtë herë.

Ermonela Felaj – Situata është shumë më optimiste se kaq, sepse ligji nuk detyron thjesht bashkitë që të angazhohen për mbrojtjen civile, por edhe institucionet qendrore do të kenë detyrimin për të ndarë nga buxhetet e tyre, buxhet për mbrojtjen civile. Njëkohësisht, ligji i jep zë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, një agjenci të cilën më herët ne e kemi thirrur vullnetarisht në këtë komision, ndërkohë që tani na detyron ligji që ta thërrasim, që është Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Buxheti i kësaj Agjencie edhe pse është një me buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, miratohet veçmas. Kështu që në momentin kur ne të vijmë te buxheti do të flasim me zotërinjtë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe do të kujdesemi për të marrë informacion nëse buxheti i institucioneve qendrore është përdorur ashtu si thotë ligji, nëse vetë Agjencia e ka bërë që më herët hartën e njësive administrative, të cilat rrezikohen nga fatkeqësitë natyrore, nëse e kanë të përcaktuar edhe bashkitë, që, detyrimisht, duhet të ecin në këtë drejtim, sepse jo të gjitha bashkitë rrezikohen njësoj. Ju e thatë në fjalën tuaj dhe ashtu është, që vitet e fundit Shkodra dhe Fieri janë rrezikuar më shumë nga fatkeqësi natyrore, por kjo nuk do të thotë se qytetet e tjerat janë të imunizuara, sepse fatkeqësitë janë nga më të ndryshmet. Sidoqoftë duhet të ketë një planifikim në drejtim të parandalimit të tyre dhe parandalim do të thotë jo thjesht të ndërpresësh ndodhjen e ngjarjes, sepse ndonjëherë ajo mund të mos jetë e mundshme për t'u ndërprerë, por të zvogëlosh pasojat që mund të vijnë nga kjo ngjarje nëpërmjet ndërhyrjes së përshtatshme në kohën e duhur.

Fjala për zonjën Gjebrea dhe më pas kalojmë në miratimin në tërësi të projektit.

Elona Gjebrea - Duke falënderuar zëvendësministrin dhe drejtorin për të gjithë prezantimin e detajuar, gjithashtu edhe kolegët, do të them vetëm një fjali, meqenëse do të kemi mundësi të flasim edhe nesër.

Unë do të doja të dija diçka më shumë lidhur me Qendrën e Trajnimeve për Mbrojtjen Civile, por mund ta diskutojmë edhe nesër: a keni parashikuar ndonjë risi apo kjo është qendra ekzistuese, sepse besoj se të gjitha këto marrin një përmasë tjetër në kushtet kur ne kemi një ligj shumë të avancuar dhe një ligj që, në fakt, u jep shumë kompetenca dhe shumë fuqi? A keni një strategji të mirëfilltë sesi do të bëni të mundur monitorimin dhe implementimin e të gjitha këtyre detyrimeve? Në fakt, nga vetë diskutimet që u bënë këtu, nuk është një gjë e lehtë fakti që kemi të bëjmë me shumë pushtete, gjë e cila e bën punën edhe më të vështirë. Prandaj, i gjithë përcaktimi ligjor, detyrimet ligjore na ndihmojnë që të evitojmë të gjithë ato situata për të cilat ne kemi qenë dëshmitarë, që disa prej tyre kanë ardhur për arsye të mungesës ligjore dhe disa të tjera për arsye të moskoordinimit edhe të pafuqisë ndërmjet shumë hallkave. Unë jam shumë e bindur se ky ligj është një risi për sa i përket mbrojtjes civile, aq më tepër duke pasur parasysh të gjithë ngrohjen globale, si dhe të gjitha ndryshimet klimaterike. Ne nuk duhet të kemi iluzionin se këto gjëra na ndodhën një herë dhe nuk do të na ndodhin më. Jo më kot edhe në prioritet e presidencës së OSBE-së së këtij viti në komitetin e dytë ishin pikërisht ndryshimet klimaterike dhe të sigurisë. Unë shpresoj se ky ligj do të na ndihmojë edhe në këtë kuadër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Po, zoti Çako.

Haki Çako – Atëherë, në lidhje me Qendrën e Trajnimeve për Mbrojtjen Civile mund të sqaroj se kjo është një pjesë e detyrimeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila do të ngrihet dhe nuk bëhet fjalë për çfarë është tani. Gjithashtu, do të ngrihet Qendra e Trajnimeve për Mbrojtjen Civile duke implementuar praktikën dhe përvojat më të mira të BE-së, ashtu sikurse janë një sërë detyrimesh, siç është sensibilizimi i të gjitha shtresave, grupeve të interesit dhe shoqërisë, ashtu sikurse është vullnetarizmi, por, mbi të gjitha, është përgatitja për t'u paraprirë të gjitha situatave.

Elona Gjebrea – Ndoshta ne do ta diskutojmë nesër këtë temë, por më duket sikur nuk është shprehur qartë pjesa e kësaj strukture dhe unë prandaj ju pyeta për qendrën e trajnimeve. Këtu del sikur është në vazhdimësi dhe ne thjesht do të vazhdojmë ta përdorim atë hallkë që kemi, por ndoshta e kam unë gabim.

Haki Çako – Janë një sërë elementesh, të cilat do të sqarohen dhe do të specifikohen vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi ligji do të merrte masa galopante nëse do të futeshim në detaje dhe në shumë elementë.

Ermonela Felaj – A ka diskutime të tjera nga koleget? Nuk ka.

Unë dua t'i mësoj edhe njëherë faktit se ligji është natyrisht i rëndësishëm. Jemi ne ata që, në fund të ditës, në detyrën tonë si të zgjedhur, do të përballemi me kërkesat e njerëzve për kompensim në momentin kur do të ndodhin fatkeqësitë natyrore. Kështu që duhet të jemi të kujdesshëm që ndërveprimi i hallkave të ndryshme për mbrojtjen civile të jenë sa më efektiv.

Në fakt, jemi të detyruar që ta mbyllim këtu diskutimin dhe nesër të kalojmë në diskutimin nen për nen, edhe për faktin se ne jemi komision përgjegjës dhe na duhet të administrojmë edhe raportin e Komisionit të Ligjeve dhe atë të Komisionit të Integritetit, meqenëse ligji ka edhe përafrime me direktivat europiane. Pra, është e nevojshme që t'i kemi të dyja raportet.

Gjithsesi, dua të sjell në vëmendjen tuaj, duke u nisur edhe nga diskutimet edhe nga pyetjet që u bënë gjatë ditës së sotme, disa pika, të cilat duhet t'i mendojmë që sot për nesër, për të gjetur një zgjidhje konsensuale, si për shembull afati i parashikuar për nxjerrjen e akteve nënligjore, si dhe afati tejet i gjatë për përgatitjen e strategjive.

Ligji ka marrë vetëm një vit kohë nga momenti kur Kryeministri ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës, ndërkohë që afatet që parashikohen këtu, nuk po flas për strategjinë kombëtare, sepse ndoshta strategjia kombëtare kërkon një kohë disi më të gjatë, por për disa akte të tjera nënligjore janë të pajustificueshme, pra që të ketë një afat 3-vjeçar për përgatitjen e tyre. Kështu, nga ana e këtij komisioni është e sigurt se do të ndërhyhet në këto afate për shkurtimin maksimal të tyre, për një arsye shumë të thjeshtë: ky ligj duhet të bëhet efektiv sa më shpejt. Në çdo raport-progres është shënuar si pikë e dobët për Shqipërinë mungesa e këtij ligji dhe mungesa e një sistemi efektiv për mbrojtjen civile, kështu që ne nuk mund të marrim më tepër kohë dhe të shkojmë deri në vitin 2022. Pra, le të shikojmë në një kohë të mjaftueshme për strategjinë kombëtare për planet e tjera të bashkive, që duhet të kenë një kohë domosdoshmërisht më të shkurtër. E di që ju do të më thoni se ato duhet të ndjekin strategjinë, prandaj do të fokusoheni që strategjia të bëhet në kohë. Neve nuk do të na duhet të kopjojmë dhe të shpikim rrotën, sepse ligji është bërë me asistencë të huaj. Unë shpresoj që kjo asistencë të vijojë, por do të doja që në këtë pikë ne të reflektojmë. Gjithashtu, unë besoj se duhet të reflektojmë edhe në një pikë tjetër (këtë nuk po e them për të vazhduar debatin, por për ta pasur parasysh për ditën e nesërme është dhe një çështje, të cilën ne

nuk e prekëm), që ligji parashikon se në momentin kur kostoja e një fatkeqësie e kalon 8%-shin e buxhetit të çdo bashkie, atëherë ndërhyjnë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile së bashku me Komitetin e Mbrojtjes Civile për të bërë kompensimin. Një pyetje që më duket se e ka të vështirë të marrë përgjigje është: në momentin kur bashkitë e kanë detyrim për t'u përgjigjur me 4%-shin e buxhetit, logjika e thjeshtë të thotë se kur kalohet ky 4% duhet të ndërhyjë shteti, por jo kur kalohet 8%-shi!. Këtë gjë duhet ta shikojmë ditën e nesërme, por ndërkohë do të doja që të kishim edhe vërejtjet e kolegëve.

(Diskutime pa mikrofon)

Haki Çako – Çështja e përcaktimit të përballimit ka të bëjë me situatën kur ndodh dhe me pasojat që vijnë. Normalisht ka fatkeqësi vendore, rajonale ose qarku dhe ka fatkeqësi kombëtare. Pra, kjo gjë është e lidhur ngushtësisht me përmasat që ka fatkeqësia. Sigurisht, shteti është gjithmonë i vëmendshëm dhe është në krye të të gjitha gjërave që ndodhin.

Ermonela Felaj – E sigurojmë zotin Çako që ne do të jemi shumë të vëmendshëm nesër kur të diskutojmë kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Atëherë, kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për mbrojtjen civile”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Projektligji “Për mbrojtjen civile” miratohet në parim.

Nesër në orën 10:00 do të vijojë mbledhja për miratimin nen për nen.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA